

FTESË PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
Adresa	Rr. Muhedin Llagani, Nr. 10 Tiranë.
Tel/Fax	0355 688015833
E-mail	dpshttr@dpshttr.gov.al
Faqja e Internetit	www.dpshttr.gov.al

OBJEKTI:

PËR MARRJEN ME QIRA TË PASURISË NGA TË TRETËT PËR USHTRIM AKTIVITETI, DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TE TRANSPORTIT RRUGOR

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor njofton të interesuarit/ofertuesit se kërkon të marrë me qira godinë/objekt ndërtimor për ushtrimin e veprimtarisë së administratës së këtij institucioni, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Të jetë objekt ndërtimor me sipërfaqe rreth 1000 m², e domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit dhe me hyrje të vecantë,
- Lartësia e katit jo më pak se 3 m;
- Objekti të jetë i hipotekuar (dokumentacioni vërtetues certifikatë/vertetim pronësie, kartelet dhe hartet treguese të jetë i tre muajve të fundit) dhe të ketë një gen – plan, ku përcakton vendndodhjen dhe sipërfaqen e ambientit të ofruar si dhe planimetrinë të hartuar nga një inxhinier/subjekt i licensuar;
- Deklaratën noteriale nga pronari i pasurisë së paluajtshme që nuk ka konflikt me palë të treta;
- Nisur nga rëndësia e lartë e institucionit të ofrohet shërbimi për ruajtjen e sigurisë së ambientit;
- Në sipërfaqen e kërkuar të jetë i vendosur dhe funksional Sistemi MNZ (sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit);
- Të jetë i pajisur me Sistemin e ndriçimit të emergjencës dhe sinjalistikë që të të udhëheqë drejt daljeve të emergjencës;
- Ambienti të ketë sistem monitorimi me kamera 24 orë;
- Të ketë sistemin e aksesimit të hyrje/daljeve (check in/checkout) të stafit duke ofruar kartat për cdo punonjës;
- Në objekt të jetë i siguruar furnizimi pa ndërprerje me energji elektrike;
- Furnizim me ujë pa ndërprerje;



- Gjenerator për të siguruar energji elektrike 24 orë, (e domosdoshme për funksionimin e serverave dhe pajisjeve);
- Të ketë të instaluar dhe funksional sistemin e kondicionimit Ngrohje/Ftohje në të gjithë hapësirën dhe të përfshijë mirëmbajtjen e pajisjeve për gjithë periudhën e qerasë;
- Ambienti të jetë i pajisur me të gjithë mobilimin e nevojshëm për akomodimin e rreth 80 punonjësve me poste individuale (një post nënkupton 2 priza fuqie dhe 1 prizë rrjeti LAN), ku përfshihen:
 - o Ndricules në të gjithë ambientin,
 - o Tavolinë pune për cdo punonjës,
 - o Karrige për cdo punonjës,
 - o Komodinë personale për cdo punonjës,
 - o Tavolinë dhe karrige për recepsionin,
 - o Karrige ulëse në zonën e pritjes,
 - o Raftë për dokumenta për cdo punonjës;
- Në këtë ambient të jetë i ndarë zyra e drejtuesit të institucionit Sip. jo më pak 70 m2 ku përfshihet zyra e asistentes dhe zyrë pritje e pajisur me mobilet e nevojshme;
- Të ketë zyra të ndara me Sip. jo më pak 20 m2, minimalisht 6 zyra të pajisura me mobilet e nevojshme (karrige, tavolinë, komodinë, raft);
- Ambienti të ketë sallë mbledhje (meeting room) Brenda kësaj sipërfaqeje të pajisur me mobiljet dhe elementët e nevojshëm (dalje për video/audio projector, TV);
- Ambienti të ketë tualete, jo më pak se 3 bokse, të pajisuar me të gjitha hidrosanitarët dhe bolier si dhe të përfshijë pastrimin dhe mirëmbajtjen e tyre;
- Të ketë një ambient të vecantë për pritjen e qytetarëve të pajisur me karrige dhe tavolinë për punonjësin dhe si dhe karrige ulëse për pritjen me qytetarët;
- Ofertuesi duhet të ketë minimalisht 100 poste pune (rrjeti Lan) të shpërndara në të gjithë hapësirën ku gjithashtu të jetë edhe dy poste energjie; (80 poste për punonjësit dhe minimalisht 20 poste për pajisje si printera e fotokopje rrjeti)
- Të ketë minimum një server room ku terminojnë të gjitha lidhjet e rrjetit Lan dhe të jenë të vendosura në Patch Panele me etiketimin përkatës. Në brendësinë e server room, të ketë një Rack 42' në të cilin do të jenë montuar aparataturat si Router, Swich, Patch Panele dhe bateri;
- Routeri duhet të jetë CISCO për arsye sigurie DPSHTRR përdor këtë lloj infrastrukturë. Ky lloj Routeri duhet të ketë Licenca VOIP, SECURITY për support VPN dhe Algoritëm AES dhe 3DES, gjithashtu Routeri duhet të suportojë minimum një SFP me ThroughPut mbi 1 Gbps. Routeri të jetë Rack Mounted;
- Swich-et duhet të jenë me porta Gigabit të menaxhueshëm dhe POE, të kenë minimalisht 120 porta. Këto Swich – e të jenë Rack Mounted;
- UPS të jetë minimalisht 4 kw, Rack Mounted;
- Të përfshihet pastrimi i ambientit brenda dhe jashtë dhe ambjenteve të përbashkëta;
- Të përfshihet mirëmbajtja e objektit dhe pajisjeve gjatë gjithë periudhës së qerasë;



- Brenda ambientit të ketë një hapësirë të veçantë ngrënie e pajisur me të gjitha mobiljet dhe elementët e nevojshëm;
- Të ketë jo më larg se 50 m nga objekti restorant (mencë) për plotësimin e nevojave të punonjësve;
- Të jetë i pajisur me rampa apo ashensor (kur nuk është kati përdhe teknik) për aksesin e personave me aftësi të kufizuara;
- Në rast se ambienti ndodhet më lart se kati përdhe teknik, preferohet të jetë i pajisur me ashensor;
- Të sigurojë minimalisht 20 vende parkimi të përfshirë në cmim, në një distancë jo më shumë se 50 m nga ambient;
- Në rast se ambienti i ofruar ndodhet jashtë perimetrit të Unazës së Madhe të Tiranës në cdo rast jo më larg se 20 km, duhet të sigurojë dhe të ketë transportin për të gjithë punonjësit e DPSHTRR-së;

2. Ofertat që do të paraqesin konkurrentët për konkurrim përbëhet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

- Kërkesa e subjektit për pjesëmarrje në konkurrim;
- Oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë për m², me afat 2-vjecar.
- Formulari i sigurimit të ofertës në vlerën 2% të vlerës mujore të qirasë. Sigurimi i ofertës është i vlefshëm për 100 ditë nga afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.
- Vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka subjekti konkurrues. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e konkurruesit, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë.
- NIPT/NUIS-i, certifikata e regjistrimit dhe certifikata historike e regjistrimit të subjektit në QKB; në rast se është person fizik apo juridik.
- Vërtetimi nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore apo taksat vendore dhe sigurimet shoqërore;
- Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.
- dokumentacioni vërtetues certifikatë/vertetim pronësie, kartelet dhe harte treguese të jetë i tre muajve të fundit) .
- një Gen-plan, ku përcakton vend-ndodhjen dhe sipërfaqen e ambientit të ofruar si dhe planimetrinë të hartuar nga një inxhinier/subjekt i licensuar;
- Deklarata e hollësishme për vënien në funksionim të objektit, sipas të gjithë kritereve të kërkuara, komisioni i negocimit rezervon të drejtën për verifikimin në vend të godinës me kriteret e kërkuara para marrjes së një vendimi përfundimtar.



Ky dokumentacion të paraqitet në një zarf, të mbyllur, nënshkruar nga ofertuesi, me mbishkrimin “Ofertë për dhënie me qira” dhe i dorëzohet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor në datën dhe orën e hapjes së konkurrimit. Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

Dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje e noterizuar.

Mosparaqitja e njërit prej dokumentave të mësipërme, përbën kusht skualifikues.

3. Vendi i zhvillimit të konkurrimit: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor , zyra e protokollit, me adresë: Adresa: “Rr. “Muhedin Llagani” Nr.10”, Tiranë; Tel.: +355 69 801 5 833 Fax.: +355 (0) 4 2238175;
4. Ofertat dorëzohen nga të interesuarit/konkurrentët, fizikisht, me poste ose dorazi, në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrimit.
5. Afati i fundit kohor për dorëzimin e ofertave konkurruese do të jete data : 30/04/2019 ora 12:00

